



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1097 /2024

Datë: 31 tetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 30 dhe 34 të Rregullores Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 31 tetor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Raporti final i Komisionit për Rekrutim, së bashku me propozimin e listës përfundimtare të njëzetekatër (24) kandidatëve për Prokurorë të Shtetit në Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretariati që Raportin e cekur në pikën 1 së bashku me këtë vendim t'i publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe të hartoj Vendime të veçanta për çdo prokuror të propozuar për emërim te Presidenti i Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Blerim Isufaj, Kryetar i Komisionit për Rekrutim;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.